



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTER
NJËSIA E PROKURIMIT

Ballsh, më 26.08.2022

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Studim projektim të objektit: “Ndërtim i ujësjellësit të fshatrave të Nja Aranitas”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):

22114311-5

Vlera e fondit limit:

11,632,680 (njëmbëdhjetëmilion e gjashtëqind e tridhjetë e dymijë e gjashtëqind e tetëdhjetë)
Lekë pa TVSH

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhëri përkatës i prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesë blerjes (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a.** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b.** Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c.** Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenet 26, 29 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, dhe nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Raporti pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të bilanceve të dy viteve të njëpasnjëshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësi/a/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrorjnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.3. Kapaciteti teknik:

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat si vijon:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqitet kontrata e lidhur e shoqëruar me vërtetimin përkatës të lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kontratës.

ose

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm, pasi garanton Autoritetin Kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të zotërojë liçencat e nevojshme për ekzekutimin e shërbimit objekt kontrate. Për këtë duhet të paraqesë liçencën profesionale të shoqërisë në projektim, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

- 3.d - Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe matalike
- 4.a - Projektim të instalimeve hidro-termosanitare
- 4.c - Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale
- 4.j - Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, accecc kontrolli, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale
- 5.b - Projektim furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi
- 5.c - Projektim ujësjellës kanalizime ubane - rurale
- 5.f - Projektim vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi - shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse
- 8.a - Rilevime inxhinierike

- 8.d - Bazamente gjeodezike
- 9.a - Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate
- 9.d - Studim/Vlerësim gjeologo inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët
- 9.e - Studime e projektme hidrogjeologjike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM nr.943 datë 28.12.2016. Me anë të kësaj kërkesë, synohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve objekt kontrate, të lëshuara nga autoritetet kompetente duke u bazuar në kërkesat specifike të përcaktuara në detyrën e projektimit.

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë, me pozicionin Drejtues Teknik, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Mekanik
- Inxhinier Elektrik
- Inxhinier Gjeolog
- Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder
- Inxhinier Hidroteknik

Për specialistët e mësipërm (Drejtues Teknik) Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontratat noteriale të punës të vlefshme, diplomat, cv, licencat profesionale, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të shërbimeve objekt kontrate. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë të lëshuar nga QKB/QKL, Kodi III.2.A (1+2) për “Veprimtari të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit në mjedis)” ose të ketë kontratë të rregullt pune me një ekspert të pajisur me licencë të lëshuar nga QKB/QKL, Kodi III.2.A (1+2) për “Veprimtari të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit në mjedis)” ose të ketë kontratë të rregullt pune me një ekspert të pajisur me certifikatë për “Hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor” të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Në rast se Operatori Ekonomik ofertues është i licencuar me licencë të lëshuar nga QKB/QKL, Kodi III.2.A (1+2) për “Veprimtari të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit në mjedis)” duhet të paraqitet licenca përkatëse. Ndërsa kur nuk është vetë i licencuar, por ka kontratë të rregullt pune me njërin prej ekspertëve për dy rastet e tjera të parashikuara, kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të kësaj kërkesë, synohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat apo certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, të cilat lidhen me kryerjen e shërbimeve objekt kontrate, duke u bazuar në kërkesat specifike të përcaktuara në detyrën e projektimit.

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar gjithashtu staf mbështetës të kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier topograf
- 1 (një) inxhinier hidroteknik
- 1 (një) inxhinier mjedisi
- 1 (një) inxhinier ndërtimi

Për stafin mbështetës duhet të paraqiten kontratat e punës të vlefshme, diplomat, cv, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën **për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.**

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të shërbimeve objekt kontrate. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6. Për ekzekutimin e shërbimeve objekt kontrate, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht, të paktën **10 (dhjetë) punonjës** të siguruar, **për tre muajt e fundit** nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë, kualifikimi i punonjësve, grafiku i ekzekutimit të shërbimeve, natyra e shërbimeve, përmasat e kontratës që prokurohet, etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje minimalisht **për tre muajt e fundit**, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.7. Bazuar në njoftimin e APP me nr.5585 prot, datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe rekomandimit të APP me nr.6559 prot, datë 27.06.2018, për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë parasysh sa më poshtë:

Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Vlera limit prej **11,632,680** (njëmbëdhjetëmilion e gjashtëqind e tridhjetë e dymijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) **Lekë pa TVSH**, është vlera maksimale e llogaritur me vlerat e tarifave maksimale për grupin përkatës.

Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Gjithashtu, kjo kërkesë është përcaktuar duke u bazuar edhe në nenin 7, pika 1, të VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Orientim për Operatorët Ekonomikë:

Vlera e përafërt e përllogaritur për ndërtim-montimin e objektit është në shumën prej 250,000,000 (dyqind e pesëdhjetëmilion) lekë pa TVSH. Kosto totale e ndërtim-montimit do të jepet nga preventivi përfundimtar i objektit. Kostoja do të përgatitet bazuar në studimin dhe projektimin e objektit të zbatimit, specifikimet teknike, etj, duke marrë parasysh edhe kërkesa të veçanta të Bashkisë Mallakastër në lidhje me standardet e pranuar dhe me çmimet për njësi sipas manualit teknik të çmimeve, miratuar me V.K.M. nr. 629, datë 15.07.2015.

Objekti bën pjesë në grupin e tretë tarifor.

Argumentimi i specifikimeve teknike/termat e referencës

Specifikimet teknike/termat e referencës për procedurën objekt prokurimi, janë sipas Detyrës së Projektimit të hartuar nga DAZHTK, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Mallakastër. Detyra e Projektimit është pjesë e dokumentave që do të publikohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përlllogaritja e fondit limit, është realizuar nga DAZHTL, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Mallakastër, duke u bazuar në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Afati i realizimit për hartimin e projekt zbatimit dhe preventivit përfundimtar është parashikuar të jetë 3 (tre) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Në zbatim të nenit 56, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, formulari i njoftimit të kontratës dhe dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi, do të ngarkohen dhe dërgohen për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe buletin e njoftimeve publike.

Bazuar në nenin 42, pika 5, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, afati kohor për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.

Duke qenë se kjo procedurë prokurimi zhvillohet me mjete elektronike, shihet e arsyeshme që afati për pranimin e ofertave të shkurtohet me 5 ditë. Shpallja e njoftimit të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem. Në këtë kuptim, afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave do të jetë:

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data 13.09.2022, ora 10:00, prokurim elektronik në adresën www.app.gov.al

Kërkesat e veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, janë hartuar dhe argumentuar nga z. (Ing. Ndërtimi - specialist i fushës në urdhërin e prokurimit), sipas procesverbalit të datës2022 “Mbi hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, për procedurën e prokurimit publik “Studim projektim të objektit: “Ndërtim i ujësjellësit të fshatrave të NjA Aranitas”, procesverbal i cili administrohet në dosje. Kërkesat e veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, pasqyrohen në shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2.3. “Kapaciteti teknik”, nën-pikat 2.3.1. – 2.3.7.

Personi i autorizuar për kryerjen e veprimeve në SPE:

Për këtë procedurë, Njësia e Prokurimit autorizon z. për ngarkimin e dokumentacionit dhe kryerjen e veprimeve procedurale në sistemin e prokurimit elektronik.

Në përfundim anëtarët e Njesisë së Prokurimit nënshkruajnë këtë procesvebal i cili përbëhet nga 10 (dhjetë) fletë dhe administrohet në dosjen e prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT